

Është falur në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, Namazi i Kurban Bajramit, ku është bërë thirrje për paqe, dashuri, harmoni e solidaritet mes njerëzve në tërë botën. Ceremonia qendrore me rastin e Kurban Bajramit është mbajtur në Xhaminë 'Sulltan Mehmet Fatih', e cila njihet si Xhamia e Madhe, nën organizimin e Bashkësisë Islame të Kosovës. Drejtuesit e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) kanë bërë thirrje për paqe mes njerëzve në botë, pasi sot më shumë se kurrë bota ka nevojë për paqe, dashuri, solidaritet e harmoni mes vete.

Sekretari i Përgjithshëm i BIK-ut, Resul Rexhepi tha se përveç prerjes së kurbanit, qytetarët kanë rastin t'i ndihmojnë edhe të varfërve, edhe skamnorëve, edhe jetimëve sepse kjo do të ofroj njerëzit mes vete.

“Sot në këtë ditë gëzimi të gjithë besimtarët që në zemrat dhe shpirtin e tyre shndrit besimi i singertë, besim i cili motivon dhe fuqizon veprat tona, të jemi me solidar mes vete, të jemi më human, më mëshirues dhe me tolerant. T'i lëmë urrejtjet dhe armiqësitë, të motivohemi për buzëqeshje dhe përqaftime vëllazërore. Çdo festë e jona e ka porosinë e vet, e porosia më e madhe e Kurban Bajramit qëndron fuqishëm mbi parimin e dashurisë, bujarisë, solidaritetit, barazisë dhe sakrificës. Në këtë ditë feste prej nesh kërkohet t'i harrojmë urrejtjet e mospajtimet, t'i bashkojmë zemrat tona dhe ta shtrijmë dorën e pajtimit”, tha Rexhepi.

Ai tha se kujdes të veçantë duhet të tregojnë ndaj jetimëve dhe me ndihmën e tyre t'ua lehtësojnë dhimbjen e tyre. Rexhepi tha se duhet të ndihmohen skamnorët që edhe ata të gëzohen në këtë ditë.

Rexhepi shtoi se sot kur po festohet dita e Kurban Bajramit, në botë ka shumë vatra të luftës, ku të pambrojturit, gratë, ku ka dhunë vrasje e shkatërrime, lusin Zotin që të bëj që ato vende dhe ata popuj të heqin dorë nga konfliktet dhe vrasjet.